SEKSIONI I KATËRT

ÇËSHTJA HYSEN SPATA KUNDËR SHQIPËRISË

Ankimi nr. 19985/13

VENDIM

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), e mbledhur më 1 tetor si një Komitet i përbërë nga:

Päivi Hirvelä, *president*

Ledi Bianku,

Paul Mahoney, *gjyqtarë,*

dhe Fatoş Aracı, *zëvendëssekretar i Seksionit*,

në lidhje me ankimin e sipërpërmendur, të dorëzuar më 9 mars 2013, pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura, vendos si më poshtë:

FAKTET

1. Ankuesi, z. Hysen Spata, është një shtetas shqiptar, i lindur në vitin 1942, me banim në Dibër. Ai përfaqësohet përpara Gjykatës nga z. Kamer Ylli, një avokat, i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

2. Faktet e çështjes, siç janë paraqitur nga ankuesi, mund të përmblidhen si më poshtë:

A. Hetimi penal për vdekjen e motrës së ankuesit

3. Më 22 tetor 2001, motra e ankuesit u godit për vdekje me armë në shtëpinë e saj.

4. Në dhjetor 2001, ankuesi dorëzon një ankesë penale në prokurori.

5. Më 22 dhjetor 2001, prokuroria e rrethit nisi një hetim penal për vdekjen e motrës së ankuesit.

6. Më 12 dhjetor 2002, prokurori i rrethit vendosi të pezullonte hetimet, me justifikimin se nuk mund të gjurmohej asnjë autor në lidhje me krimin. Ankuesi pretendon se deri në atë pikë, ai nuk ishte informuar për organizimin e hetimeve apo për pezullimin e tyre.

7. Më vonë ankuesi mëson për pezullimin e hetimeve. Kërkesa e tij në prokurorinë e rrethit për të marrë kopje të dokumenteve të gjetura gjatë hetimeve, dosja me nr. 161, mbeti pa përgjigje.

8. Më 26 shkurt 2004, 25 janar 2008 dhe 4 shtator 2009, Prokuroria e Përgjithshme informoi ankuesin se hetimet ishin ende të pezulluara, dhe se nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim tjetër.

B. Procedurat gjyqësore kundër pezullimit të hetimeve penale

9. Në një datë të papërcaktuar, me shumë mundësi pas shtatorit 2009, ankuesi hapi procedura penale kundër pezullimit të hetimeve. Ai u ankua se nuk ishte informuar për përmbajtjen e dosjes së hetimeve dhe as për pezullimin e hetimeve, se prokurori nuk i kishte pyetur të gjithë dëshmitarët dhe se ai nuk kishte asnjë përfitim efikas për t'u ankuar kundër vendimit për pezullim të hetimeve penale.

10. Më 16 nëntor 2009 dhe 23 qershor 2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, dhe Gjykata e Apelit Tiranë vendosën se, përderisa hetimet ishin ende pezull dhe përderisa ishte e drejta e prokurorisë të vendoste që hetimet të vazhdonin, ankuesi nuk kishte *locus standi*. U rikonfirmua se nuk ekzistonte asnjë e drejtë për të apeluar kundër vendimit për pezullim të hetimeve sipas ligjit të procedurës penale.

11. Më 22 dhjetor 2011 dhe 18 janar 2013, Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese i refuzuan apelimet e ankuesit. Ky i fundit pohoi, *inter alia*, se edhe pse ligji i procedurës penale nuk e parashikonte të drejtën për të apeluar, fakti se ankuesi kishte pasur akses në gjykatat vendase, tregonte se ai kishte një të drejtë efektive të apelonte në gjykatë.

C. Ligji përkatës vendas

Kodi i Procedurës Penale ("KPP")

12. Neni 24 § 4 pohon se vendimet dhe udhëzimet e një prokurori të nivelit të lartë lidhen me një prokuror të një niveli më të ulët.

13. Neni 58 i KPP-së parashikon se viktima apo trashëgimtarët e tij/saj kanë të drejtën për të kërkuar hapjen e një hetimi penal për autorin e krimit dhe të kërkojë dëmet.

14. Neni 105 i KPP-së parashikon se çdo palë e interesuar ka të drejtën të kërkojë kopje dhe ekstrakte, ose akte të veçanta të dosjes së hetimeve penale, në kurriz të asaj pale.

15. Neni 326 i KPP-së, i cili parashikon të drejtën e prokurorit të pezullojë hetimin penal, shpjegon si më poshtë:

"1. Kur autori i krimit është i panjohur (…), prokurori mund të vendosë të pezullojë hetimet.

2. Pezullimi i hetimeve miratohet pasi janë ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme.

3. Hetimet e pezulluara mund të rihapen me një vendim të prokurorit."

Nuk ka një parashikim specifik në Kodin e Procedurës Penale në lidhje me të drejtën për të apeluar kundër vendimit të prokurorit për të pezulluar një hetim.

ANKESAT

16. Ankuesi u referohet neneve 6, 8 dhe 13 të Konventës, për t'u ankuar se nuk ishte informuar për përmbajtjen e dosjes së hetimeve, se nuk ishte informuar për vendimin për të pezulluar hetimet dhe se nuk ka asnjë rezultat të efektshëm kundër vendimit të prokurorit për të pezulluar hetimet.

LIGJI

17. Pakënaqësitë e ankuesit nuk u shqyrtuan nga pikëpamja e detyrimit procedural të shtetit përgjegjës për të organizuar një hetim të efektshëm sipas nenit 2 të Konventës, i cili përfshin një kërkesë për të bërë të mundur pjesëmarrjen e një të afërmi. Megjithatë, kjo kërkesë nuk mund të shtrihet deri në atë pikë sa të nënkuptojë se ankuesi duhet të ketë akses në dosjet e policisë, apo në kopjet e të gjitha dokumenteve gjatë një hetimi në proces e sipër, apo që ankuesi të kontaktohet dhe të informohet për çdo hap (*Green kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr 28079/04, 19 maj 2005; *Hackett kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr. 34698/04, 10 maj 2005).

18. Më tej, Gjykata vëren se nuk kërkohet të merret një vendim nëse autoritetet pajtohen me atë kërkesë nëse ankesa është e papranueshme për arsyet e mëposhtme.

19. Neni 35 § 1 i Konventës parashikon se Gjykata mund të merret me një çështje kur ajo është prezantuar brenda gjashtë muajve nga data e vendimit final, në procesin e përvetësimit të kompensimeve vendase. Me rregull, periudha gjashtëmujore fillon që nga data e vendimit final në procesin e përvetësimit të kompensimeve vendase. Megjithatë, kur është e qartë që në fillim se nuk ka asnjë kompensim efikas për ankuesin, periudha fillon që nga data e akteve ose masave për të cilat është bërë ankesa, ose që nga data kur akti apo efektet e tij i prezantohen ankuesit (*Dennis dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr. 76573/01, 2 korrik 2002). As neni 35 § 1 nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që t'i japë mundësinë ankuesit të paraqesë ankesën e tij përpara Gjykatës, përpara se ajo të zgjidhet në vendin e tij. Nëse ankuesi ia akordon vetë vetes një zhdëmtim, në dukje ekzistues, dhe më pas ndërgjegjësohet për rrethanat, të cilat e bëjnë këtë zhdëmtim joefikas, për qëllimet e nenit 35 § 1, mund të jetë më e përshtatshme që periudha gjashtëmujore të fillojë nga data kur ankuesi ndërgjegjësohet ose duhet të ndërgjegjësohet për ato rrethana (shiko *Paul and Aubrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr. 46477/99, 4 qershor 2001).

20. Për pasojë, në rast se është shkaktuar një vdekje, pritet që të afërmit e ankuesit të ndërmarrin hapa për të ndjekur procesin e hetimeve dhe të dorëzojnë ankesat e tyre në mënyrën e duhur, sapo ata të jenë ndërgjegjësuar apo të duhet të ndërgjegjësohen për mungesën e një hetimi penal efektiv (shiko *Bulut dhe Yavuz kundër Turqisë* (vend.), nr. 73065/01, 28 maj 2002; gjithashtu, *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë* (vend.), nr. 38587/97, GJEDNJ 2002 III).

21. Duke iu rikthuer fakteve të çështjes aktuale, më 22 dhjetor 2001, u hap një hetim penal mbi vrasjen me armë të motrës së ankuesit. Më 12 dhjetor 2002, prokurori i rrethit vendosi ta pezullojë hetimin. Ankuesi e pranon se u njoftua për atë vendim, por nuk specifikoi një datë konkrete. Megjithatë, letrat e autoriteteve tregojnë se midis 26 shkurtit 2004 dhe 4 shtatorit 2009, ankuesi u informua vazhdimisht rreth pezullimit të hetimeve. Ankuesi nuk i referohet asnjë mase investigative të ndërmarrë që prej 12 dhjetorit 2002.

22. Për këtë arsye, Gjykata mendon se ankuesi ishte i ndërgjegjshëm, më e shumta që prej 4 shtatorit 2009, se hetimet ishin pezulluar dhe asnjë akt tjetër investigativ nuk ishte ndërmarrë që prej pezullimit dhe se nuk kishte asnjë mundësi reale për ndërmarrjen e hapave të tjerë investigativë. Limiti kohor prej gjashtëmuajsh filloi që prej asaj dite.

23. Më tej, Gjykata nuk mendon se ngrihej një detyrim i ri investigativ si rezultat i procedurave ligjore të ndërmarra nga ankuesi në vitin 2009, sepse këto procedura nuk mendohet se përbëjnë "deklarata, të dhëna apo informacione bindëse, apo të besueshme, të lidhura me identifikimin dhe ndalimin apo dënimin e autorit të krimit" (shiko *Brecknell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 32457/04, § 71, 27 nëntor 2007). Në fakt, procedurat rikonfirmuan gjendjen tashmë ekzistuese sipas ligjit vendas, ku thuhej se nuk ekziston e drejta për apelim të vendimit të prokurorit për pezullim të hetimeve dhe përderisa nuk ka dalë asnjë e dhënë e re lidhur me çështjen, nuk ka asnjë detyrim procedural për të rihapur hetimin (shiko *McDermott dhe të tjerët kundër Irlandës dhe Keegan kundër Irlandës* (vend.), nr. 23213/09 dhe 62652/09, §§ 48-52, 25 shtator 2012). Ishte e qartë se nuk kishte asnjë arsye për të ndjekur procedurat e përmendura më sipër.

24. Kështu, duke e prezantuar ankimin e tij në vitin 2013, konkludohet se ankuesi nuk ka shfaqur kujdesin e duhur që të mund të zbatonte kërkesat që dilnin nga Konventa dhe nga vendimet e saj sipas nenit 35 § 1 të Konventës. Për këtë arsye, ankesa kundërshtohet në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës, për arsye se

nuk është dorëzuar brenda afatit kohor të duhur.

Për këto arsye, Gjykata në mënyrë unanime,

E deklaron ankimin të papranueshëm.

Fatoş Aracı	**Päivi Hirvelä**
ZËVENDËSSEKRETAR	PRESIDENT